

2020

TITULLI I PROJEKTIT:

“Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit 'Renea' për
Akomodimin e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale”

SPECIFIKIMET TEKNIKE ELEKTRIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PROJEKTIT ELEKTRIK

1. HYRJE

TITULLI I PROJEKTIT:

“Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit 'Renea' për Akomodimin e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale”.

Realizimi i instalimeve të impianteve elektrike në objektin është projektuar të realizohet në mënyrë të atillë që të sigurojë në çdo moment, punën normale të personelit të të gjitha llojeve të aktiviteteve, punën normale të të gjitha llojeve të aparaturave duke filluar nga më të thjeshtat deri tek ato më të komplikuarat, duke siguruar afate maksimale të skemave të furnizimit, matjes, sinjalizimit dhe atyre të kontrollit. Në mbështetje të gjithë këtyre kërkesave zgjidhjet teknike të dhëna në këtë projekt do të mundësojë me se miri plotësimin e normave CEI të instalimeve.

2. STANDARDET REFERUESE

Sistemet elektrike do të jenë të dizajnuara në përputhje me rregullat dhe standartet e instalimeve ndërkombetare dhe lokale.

Kështu për INSTALIMET ELEKTRIKE do të respektohen standartet:

- CEI 0-2 Udhëzues për përcaktimin e dokumentacionit
- CEI 11-35 Udhëzues për ekzekutimin e kabinave elektrike
- CEI 11-1 Impiante elektrike për tensionin alternativ më të madh se 1 kV.
- CEI 11-17 Impiante të prodhimit, Transportit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, Linjat elektrike.
- CEI 11-20 Impiante të prodhimit të energjisë alternative, grupet e elektrogjeneratoreve të lidhura në rrjete të kategorisë I dhe II.
- CEI 11-25 Rrymat e lidhjes së shkurtër, në sistemet trefazore alternative. Llogaritjet e tyre.
- CEI 11-26 Rrymat e lidhjes së shkurtër, llogaritja e efekteve. Definicionet dhe metodat e llogaritjeve.
- CEI 17-13/1 Siguria e pajisjeve të manovrimit në tension të ulët (Kuadrat të tensionit të ulët)
- CEI 64-8/1 Përdorimi i impianteve elektrike në tension nominal jo më të madh se 1000 V alternativ dhe 15000V të vazhduar.
- CEI 81-10/1-4 Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike (rrufe)
- CEI 103-1/1 a 103.1/16 Impiantet telefonike të brendshme
- UNI EN 12464-I Sistemet e ndricimit të brendshëm, të posteve të punës.
- UNI Standard 9795 - sistemet fikse të zbulimit dhe sinjalizimit automatik dhe alarmit të zjarrit.
- UNI EN 1838 Pajisjet e ndricimit, Ndricimi i emergjencës.
- CEI EN 50173-1 Teknologjia e informacionit- Sistemet e kabllimit të përgjithshëm, - Planifikime dhe kriteret e instalimeve brenda ambienteve të brendshme
- IEC 60076-11 Përdorimi I transformatorëve trefazorë të thatë .
- IEC 103-1 / N PABX central.
- 60617/1-2 simbolet CEI EN – grafikët e përdorura për diagrame etj

- CEI 3-8 Shkurtime dhe simbole për skicat ne plane.
- CEI përdoruesit elektrike 64-8/1-2-3-etc
- CEI / UNI Te produkteve qe aplikohen për projektimin, ndërtimin, testimin ne fabrikë dhe instalimin e materialeve, komponentëve dhe pajisjet elektrike.

Projekti elektrike do te permbaje keto sisteme:

- Struktura e ambjenteve
- Tipologjia e pajisjeve
- Skemat dhe llogaritjet e ngarkesave sipas kerkesave.
- Sistemi i furnizimit me energji emergjent-Gjeneratoret
- Struktura e ambjenteve
- Tipologjia e pajisjeve
- Sistemi i furnizimit me energji i sigurise UPS.
- Linjat kryesore te furnizimit me energji te Paneleve elektrike kryesor nga power center
- Karakterisitikat funksionale te rrjetit te shperndarjes kryesore
- Rrjeti dytesor i shperndarjes
- Kuadrot elektrike
- Kuadrot elektrike te katit, zones
- Rrjeti dytesor i shperndarjes
- Kuadrot e ambjenteve te vecanta.
- Rrjeti i pergjithshem i fuqise.
- Furnizimi i konsumatoreve te pergjithshem nga rrjeti normal
- Furnizim i konsumatoreve preferenciale nga gjeneratori
- Furnizim i komsumatoreve te rendesishem nga UPS
- Rrjeti i ndricimit
- Rrjeti i ndricimit normal te pergjithshem
- Rrjeti i ndricimit te jashtem etc
- Rrjeti i ndricimit te sigurise
- Rrjeti i ndricimit emergjent
- Rrjeti i ndricimit te evakuimit etc.
- Rrjeti i tokezimit, shkarkimeve atmosferike dhe skemave ekuiipotenciale

Projekti e instalimeve speciale do te permbaje keto sisteme:

- Impiantet e sistemeve te sigurise
- Impianti idedektimit dhe sinjalizimit te zjarrit
- Impianti i lajmerimit zanor
- Impianti kunder hyrjeve te padeshiruara
- Impianti i kontrollit te dyerve
- Impianti i monitorimit CCTV.
- Impiantet e sistemeve te komunikimit
- Impianti i kablllove te strukturuar, Fiber optike

- Pajisjet aktive te rrjetit te transmetimit te te dhenave

Sistemet e mesiperme do te jene te shoqeruar me te gjithë llogaritjet, dhe specifikimet teknike te perzgjedhura.

3. SISTEMI I FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE.

Eshte parashikar furnizimi me energji elektirke ne menyre te pavaruar nga rrjeti ne TU i qytetit.

Per kete objektet do te furnizohen nga kabina elektrike qe do te ndertohet jashte godines se “Ish komandes” ne ambjentin e parashikuar me nje transformator me fuqi 400 KVA . Duke qene se furnizmi nga rrjeti i qytetit do te merret ne Tension te Mesem edhe matja e energjise per gjithë Institucionin do te behet ne Tension te mesem nepermjet Celes se Matjes ne TM. Kjo do te beje te mundur edhe uljen e kostove te energjise duke qene se do te aplikohen tarifat per matje ne TM.

Aktualisht Institucioni ka nje kontrate te Furnizimit me energji per nje fuqi te caktuar, fuqi e cila do te vazhdoje te jete ne vleren totale te fuqise se kerkuar dhe kerkesa per lidhjen e fuqise do te behet vetem per shtesen e fuqise pra vleren e fuqise totale qe jepet ne tabelen me poshte duke zbritur fuqine aktule qe ka ne shfrytezim Institucioni.

Furnizimi me energji elektrike do te behet nga paneli kryesor Power Center i objektit e cili ndodhet dhomen teknike te Tensionit te Ulet dhe eshte paraqitur ne planet perkatese ne vizatim. E gjithë shperdarja dhe lidhja e nenkuadrove elektrike do te behet nga paneli kryesor sipas skemave njefillore.

Llogaritja e fuqise se kerkuar

Transformatori, 400 KVA

Fuqia Laboratori:

Pajisje Mekanike = 36 KW

Ndricimi i jashtem = 15 KW

Furnizim nga UPS = 86 KW

Konsumator nga rrjeti normal dhe gjeneratori = 300 KW

Total= 437 KW

Fuqia totale e objektit:

Pinstaluar . = 437 kW

Pkerkuar . = 0.7 x 437 kW = 305.9 kw

Fuqia e Plote = S = Pkerkur / cos φ = 305.9 / 0.94 ≈ 325 kVA

dhe Fuqi e kerkuar eshte: Pperk = 325 KVA.

- Piku i ngarkeses, per kete lloj konsumatori arrihet neoret 08 – 16, si per periudhen e veres ashtu dhe per periudhen e dimrit. Periudha e pik-ut perafrohet, kur ora astronomike ndryshon ne pranvere dhe ne vjeshte (-1/+1 ore)
- Fuqia e elektromotorit me te madh eshte 11 kw per pompat e UTA.
- Ngarkesa elektrike ne objektet e ndryshme eshte shperndare ne menyre simetrike ne te 3 fazat, duke u realizuar ne te gjithë panelet e mbrijtjes perkatese. Ngarkesa eshte e limituar me automat magneto-termik te vendosur ne panelin e tensionit te ulet ne kabine. Kjo ngarkese (rryme e limitatorit), percaktohet ne kontraten tip te Entit furnizues me energji elektrike)

- Ne te gjitha llogaritjet si dhe ne percaktimin e seksioneve percjellesave, plotesohet kushti qe, devijimet e tensionit deri tek konsumatori i fundit nuk kalojne vleren: $U\% < 2-4\%$ (llogaritjet jane bere qe nga BTU deri tek perdoruesi i fundit)
- Zgjedhja e te gjitha pajisjeve kumutuese ne kuadrot qe ndodhen ne distancembi 60 ml nga kuadri I T.U. I kabines elektrike duhet te plotesoje kushtin qe aftesine shkeputese nga rrymat e lidhjes se shkurter 1 ose 3 fazore; $I_{cc}(lej) = 6kA$, kurse per distance $L > 60ml$, $I_{cc} = 4.5kA$.

Duke qene e fuqia e objektit eshte e konsiderueshte eshte propozuar qe te ndertohet nje kabine elektrike e re. Kabina elektrike do te pajiset me 1 transformator me fuqi 400 KVA me nivele tensioni 20/0.4 kv. Gjithashtu kabina do te pajiset edhe me celat e reja (cele hyrje, cele dalje, cele transformatori dhe cele matje)

Rezervimi me energji elektrike i godinave do te realizohet me disa metoda te pavarura:

1. Rrjeti normal i cili furnizohet nga operatori vendas OSHEE (kompani vendase e shperndarjes se energjise) ne vend.
2. Moto-gjeneratorë silencioz i vendosur i cila do të llogaritet për konsumatorë të veçante në përputhje me kërkesat e objektit.
 - Gjeneratorii zgjedhur do të jetë në përputhje me llogaritjet e konsumatorëve dhe kategorinë që do të kërkojë këtë shërbim.
 - Ai do të jetë silencoze, deri në 65 db ne distance 1 m, montuar në zonën e pershtatshme me mundesi per kontrollin, transportin dhe kryerjen e te gjitha sherbimeve në rast të defekteve dhe problemeve gjatë mirëmbajtjes.
3. UPS, të cilet janë të dedikuar për konsumatorët e preferuar të objektit, dhe konsumatorët shumë të sigurte, nga të cilët furnizimi me energji do të jetë nga UPS të pavarur për sistemet e sigurisë. Ndarja e këtyre konsumatorëve eshte percaktuar nga nevojat, kërkesat dhe në përputhje me skemat elektrike jane percaktuar ngarkesat e ketyre konsumatoreve.
 - UPS e zgjedhur do të jene prodhime me standartet e kërkuara për shërbimet me konsideratë të veçantë, duke garantuar cilësi të lartë, siguri për furnizimin e qarqeve të ndryshme të cilat do të ndahen në bazë të kërkesave te përfituesve. Jane llogaritur për autonomi jo më pak se 10 min si dhe furnizimi do të sigurohet nga gjeneratorët.

3.1 Tipologjia e pajisjeve

Kuadrot kryesore te tensionit te ulet do te jene bokse metalike me dyer me mundesi semicilindrash per kycjen e tyre sipas kerkesave per panele mbi 400 A, ne menyre qe te siguroje nje shkalle te larte te besueshmerise dhe te krijoje mundesi per nderhyrje te mevonshme ne raste te zgjerimit te rrjetit.

Linjat qe dalin nga kuadri kryesor per te furnizuar kuadrot dytesore do te konfigurohen sipas skemes unifilare te paraqitur ne vizatime keshtu nga zbarat perkatese do te furnizohen konsumatorët e vecante ne baze te ndarjes se qarqeve te fuqise.

Kuadrot e sherbimeve speciale, te cilet furnizohen nga automate te vecante te kuadrit kryesore do te kene dalje te vecanta per furnizimin e pajisjeve te emergjences e, pompave te zjarrit etj.

Kuadrot e sherbimeve ndihmese te kabines sic jane ndricimi, priza te ndryshme sherbimi, ventilatore, pompa etj.

Kuadri i kompesatorit te fuqise i cili do te perbehet nga grupe kondensatoresh te fuqishem sipas llogaritjeve dhe do te sherbejne per rregullimin e vleres se $\cos \emptyset$ si dhe per te optimizuar dimensionimin e kablllove te fuqise.

Kuadrot automatike te Gjeneratoreve te cilet do te realizojne komutimin e Rrjetit normal nga Transformoret me ate te Gjeneratoreve ne rastet e shkeputjes se energjise nga rrjeti i tensionit te mesem.

Lidhjet elektrike te pajisjeve do te behen kryesisht me kanaline metalike elektrike te instaluar sipas planit te vendosjes se pajisjeve.

Ambjentet e tensionit te ulet si dhe ambientet e trasformatoreve do te jene te ventiluar me ane te grilave zhaluce te cilet do te lejojne komunikimin me ambientet e jashtem duke siguruar nje ventilim natyral te mjaftueshem per pajisjet dhe hapesirat e vena ne dispozicion.

4. RRJETI I EMERGJENCES, GJENERATORET

Ne rastet e mungeses se rrjetit normal per konsumatore te vecante sipas kerkeses do te sigurohet vazhdimesia e punes nepermjet Gjeneratoreve diesel, fuqia e te cileve eshte llogaritur gjate zhvillimit te projektit. Ato do te jene te tipit silencioze deri 65 db dhe me komutim automatik te pavarur nga kuadrot kryesore te tensionit te ulet. Gjeneratori do te sherbeje per furnizimin e me energji te objektit ne rastet kur kemi nderprerje te energjise nga rrjeti normal. Impianti do te jete i kompletuar me depozitat e naftes te cilat do te sigurojne pavaresi per nje kohe te mjaftueshme sipas kerkesave specifike qe ka cdo zone qe ato mbulojne. Gjithashtu do te pajisen me panelin e kontrollit i cili do te lajmeroje ne rastet e alarmit, per defektet e mundshme te grupit elektromotor, nivelin e naftes ne serbator, do te realizoje komunikimin me sistemin e menaxhimit te nderteses, etj. Gjithashtu do te jete e pajisur edhe me nje pompe per furnizimin e depozites se gjeneratorit nga depozita kryesore e cila do te jete nen monitorimin e sistemit te alarmit per raste defektesh te saj.

4.1 Struktura e ambienteve teknike

Ne katin perdhe ne ambient te hapur afer kabines elektrike sipas vizatimeve eshte parashikuar vendosja e stacionit te emergjences e perbere nga nje gjeneratore elektro-diesel 150 kw.

Levizja dhe komunikimi per keto ambiente do te realizohet direkt nga jashte ne kuoten e terrenit nga poshte ne menyre qe te jete e lehte si instalimi ashtu dhe sherbimet e mevonshme te mirembajtjes apo ndehyrjeve te tjera ne raste defektesh. Keto ambiente do te kene mundesi komunikimi per linjat dhe kabllot e fuqise dhe te kontrollit me dhomen e paneleve elektrike te tensionit te ulet dhe te komandimit automatik te gjeneratoreve.

4.2 Tipologjia e pajisjeve dhe rrjetit te shperndarjes

Stacioni i emergjences do te jete i perbere nga gjeneratore elektro-diesel te vecantei cili do te filloje dhe dale nga puna ne menyre automatike duke perdorur si lende djeges naften. Gjeneratori do te kete fuqi 150 kw, dhe tension nominal 400V per pjesen e gjithë ngarkeses elektrike ne baze te skemave elektrike.

Lidhjet midis kuadrit te komandimit automatik, gjeneratorit si dhe depozites se naftes do realizohen ne kanale te ndara ne dysHEME te mbuluar me kapak betoni sipas pozicionit te pajisjeve ne planimetri.

Grupi i emergjences do te jete i llogaritur per tembajtur ne ngarkese te plote nje fuqi deri 150 kw ne menyre qe te perballoje provat periodike nen ngarkese te pajisjeve duke perjashtuar kondicionimin dhe konsumatoret nga rrjeti normal.

4.2.1 Gjeneratori

4.2.1.1 Standartet

- Motor Diesel: ISO 3046: Motor Alternativ me djegie të brendshme
- Gjenerator: IEC 60.034: Makinat rrotulluese elektrike
- Pjesa 1: Vlerësimi dhe performanca
- Pjesa 2: Metodatat për përcaktimin e humbjeve dhe rendimentit të makinerisë rrotulluese elektrike nga provat
- Pjesa 3: Kërkesat e veçanta për tipin e turbinës të makinerive sinkrone
- Pjesa 4: Metodatat për përcaktimin e madhësive të makinës sinkrone nga provat
- Pjesa 5: Klasifikimi i shkalleve të mbrojtjes së ofruar nga rrethanat
- Pjesa 6: Metodatat e ftohjes
- Pjesa 7: Klasifikimi i llojeve të ndërtimit dhe marrëveshjes se montimit
- Pjesa 8: Markimet fundore dhe drejtimi rrotullimit
- Prodhuesi: ISO 9001

4.2.1.2 Karakteristikatat teknike

1. Renditja: Vazhdueshmeria e ngarkesës bazë siç është përmendur në vizatim. Mbingarkesë 10% të lejuar për 1 orë në çdo operacion 12 orë. Renditja e kushteve si në vend.
2. Tensioni i vlerësuar: 690 V AC
3. Tensioni operativ: shih diagramet
4. Temperatura e Izolimit te Sistemit i klasit: H
5. Eficensa e Gjeneratorit : > 0,92 në cos. phi 0,8
6. Reaktansa X "d: 12% ose më pak
7. Të përshtatshme për të punuar paralelisht, lloji sinkron, tre faze + N, furcat, sherbim i vazhdueshem.
8. Shkalla e mbrojtjes: IP21
9. Shpejtësia e rrotullimit: 1500 rrot / min.
10. Bashkim i drejtpërdrejtë elastik mes motorit dhe gjeneratorit
11. Pjesët e përbashkëta (pikë e vetme) në mes gjeneratorit duhet të shmangen.
12. Aksesoret
 - Sensorë PTC në pështjellat e gjeneratorit për mbrojtje kundër mbingarkesës dhe sinjalizator alarmi
 - Mbulese elektronik
 - Radiator dhe ventilator
 - Ngrohës te zhytur per ujin e motorit, me termostat
 - Filtra ajri, gazi, nafte dhe vaji
 - Pompë injeksioni për çdo cilindër

- Pajisjet e mbrojtjes se motorit për presionin e ulët të naftës, temperaturë të lartë e ujit, mbi-shpejtësi, mbi dhe nën tension
 - Alarm për nivel të ulet uji.
 - Pakete për start automatik me bateri me acid dhe të karikueshme, kapacitet për të pakten 5 startera
 - Mbrojtja kundër shume start-up
 - Rregullator kohe për ftohjen
 - Buton për ndalim emergjence
 - Telekomande start/stop për kontrollin dhe monitorimin në dhomën e kontrollit
 - Përzgjedhës për "automatik ose manual ose fikje"
 - Sistemi i nxjerrjes së tymit me silenciator
 - Panel kontrolli dhe monitorimi me tastiere dhe regjistrimin e ngjarjeve, me bateri rezerve
 - Depozite Gazi dhe vaji me sistemin automatik të mbushjes dhe alarm të nivelit të ulët
 - Suport metalik mbeshtetës me dërrë dhe rrethim që lejon qarkullimin e ajrit
 - Vibrator Damperi
 - Mbulesë të jashtme nga kushtet atmosferike
 - Ganxha për transport
 - Sensore në rast alarmi neqoftese ka rrjedhje dhe sinjalizim të zyrës.
13. Të gjitha cilësimet janë testuar dhe vëlosur

4.2.1.3 Permasat / Pësha

Pësha totale të përmendet në ofertë dhe të kontrollohet me strukturën e ndërtimit. Përmasat në përpunje me hapësirën e instalimit dhe të kontrollohen. Hapësirë të lirë duhet të lihet për zëvendësime.

4.2.1.4 Niveli i zhurmës

Niveli i fuqisë së zhurmës: max. 65 dB (A) në 7 m
Në përpunje me rregulloren vendase

4.2.1.5 Kodi i vlerësimi

E gjithë pajisja dhe të gjithë aksesoret e nevojshëm për funksionimin e tij janë të përfshira në cmim.

4.2.2 Depozita e naftës së gjeneratorit

4.2.2.1 Standartet

DIN 6616-D : Depozite çeliku me mur tek horizontal dhe me mur dopio për ruajtjen mbi tokë të lëngjeve ndotëse të lëngshme të djegshme dhe jo-të djegshme.
DIN 6608-2 : Depozite çeliku me mur dopio horizontal për ruajtje nëntokësore.
Ligjet dhe standardet vendore.

4.2.2.2 Karakteristikat kryesore

- Materialet: çeliku
- 2. Forma: cilindër, mur dopio
- 3. Aksesoret:
- Mbështetëse dhe fiksueset

- Pllaka mbeshtetese
- Matës
- Tub per mbushjen dhe sistem me parandalim ne rast se mbushet plotpajisje mbrojtese ne piken e mbushjes
- Celes në pikën e mbushjes me dryn bronzi
- tub ventilimi
- kontakt alarmi per nivel te ulet me komande rregullimi ne dhomen e kontrollit
- Punime pikturë dhe trajtimi antigerryerje; nëse varroset nentoke duhet te shtohet nje mbrojtese katodike
- Pajisje per zbulimin e rrjedhje dhe alarmi në dhomën e kontrollit
- Veshja vizuale për jashtë

4.2.2.3 Permasat / Pesha

Ne perputhje me hapesiren e instalimit dhe te jete e kontrollueshme.
Te lihet hapesire per mirembajtje.

4.2.2.4 Kodi i vlersimit

Ne cmim eshte perfshire e gjithë depozita e mbushur.
Ne cmim jane perfshire te gjithë aksesoret.

4.2.3 Pompa per transferimin e karburantit

4.2.3.1 Te dhenat

Si ne specifikimet mekanike.

4.2.3.2 Karakteristikat teknike

- E përshtatshëm për naftë
- Pompat fryrese elektrike, duke përfshirë edhe qarqet e tyre elektrike
- Automatet alternativ të punës te pompave fryrese, të kontrolluara nga niveli i karburantit në depozite
- Monitorimi i presionit te rënies mbi filtrin, me alarm për kontrollin e gjeneratorit dhe panel monitorimi
- Alarm per deshtimin e pompes ne kontrollin e gjeneratorit dhe panelin e monitorimit
- Mbushje automatike e gjeneratorit pasi eshte fikur
- Buton ndalim ne rast emergjence ne panelin e kontrollit te gjeneratorit
- Buton ndalim ne rast emergjence kur ka alarm zjarri
- Buton ndalim ne rast emergjence kur ka rrjedhje te karburantit
- E pajisur me valvul qe vepron ne rastet e tejmbushjes

5. SISTEMI I UPS.

Projekti ka parashikuar nje mbulim te furnizimit me energji te rrjetit nepermjet UPS te cilet do te perfshijne te gjithë konsumatorët preferenciale sic jane pajisje me qarqe elektronike te cilet kerkojne te mos u nderpritet energjia elektrike, si, sistemet e sigurise etj, ashtu edhe rrjetit kompjuterik te te gjitha ambjenteve. Ne kete impiant do te

furnizohen me energji sistemet e sigurise, ndricimit emergjent dhe te evakuimit si dhe te gjithë rrjetet e vecanta qe kane nevojë per kete sherbim. Keshtu do te kemi:

1 UPS i cili do te mbuloje konsumatore te rrjetit kompjuterik dhe sherbimeve te tjera, komplet me grupin e baterive te tipit te thate me autonomi 10 minuta te instaluar ne dhomat perkatese te mireventiluara me fuqi 100 KVA.

Cdo sistem do te jete i pajisur me kuadrin e tij elektrik te vecante i cili do te mbuloje qarqet elektrike perkatese. Ambjenti teknik ne te cilin do te montohen keto UPS do te jete i kondicionuar me nje sistem te pavarur nga pjesa tjeter e objektit.

5.1 Te dhenat teknike

5.1.1 Standartet

EN 50091 -1 -1: Siguria me UPS.

EN 50091-2: Procedurat e testimit per perpuethshmerine elektromagnetike ndermjet UPS dhe pajisjeve te tjera.

EN 50091-3: Performanca dhe metodat e testimit per UPS. CEI 146-4

5.1.2 Nevojat e UPS

UPS 400 V - AC do te furnizojë vetem sherbimin e IT. Keto jane kompjuterat dhe ekranet ne zyrat dhe serverin dhe komponentet e tjere aktive ne dhomen kryesore te IT, fotokopjet, printerat etj.

Fuqia totale e nevojshme per objektin eshte afersisht 150 kVA.

5.1.3 Prodhimi i UPS

Nje njesi qendrore per UPS eshte instaluar ne ambjentin e serverit afer dhomes se panelit te pergjithshem, me bateri dhe ventilator. Njesia eshte tip e vetme pa reduktim por me by-pass per sherbim dhe mirembajtje. Ky by-pass nuk eshte pjese e panelit qendror. Duhet te sigurohet nga nje celes me ngarkese te vecante te hapësira e njesise.

5.1.4 Shperndarja e UPS

Shperndarja e UPS fillon te panelet e vecanta te UPS. Shtrirja e kablllove do te behet ne te njejten rruge kanalinash dhe kablllosh. Tipet e kablllove jane standarte (jo me ngjyra te percaktuara)

6. LINJAT KRYESORE TE SHPERNDARJES NGA KABINA ELEKTRIKE TEK KUADROT KRYESORE

1. Shpërndarja në tension të ulët

Shpërndarja në tension të ulët fillon nga Paneli i Përgjithshëm i Shpërndarjes ne power center, deri ne instalimin e tensionit të ulët për çdo prize, celes dhe drite. Shpërndarja e tensionit të ulët do të përgatitet me ane te shinave ose kablllove, të cilat janë përshkruar më poshtë:

Paneli i pergjithshem i tensionit te ulet

Paneli kryesor i tensionit të ulët do të vendoset në dhomën teknike, të furnizuara me tension të ulët nga kompania vendase "OSHE".

Paneli kryesor i tensionit të ulët do të jetë metalik, i lyster, rezistent ndaj gerryerjes, dhe i mbyllur. Dimensionet e tij janë në varësi të pajisjeve elektrike që do të montohen që janë

në varësi të ngarkesës ndërtesës, por gjithmone duke ju permbajtur skemave unifilare te projektit.

Paneli kryesor i tensionit të ulët sipas skemave elektrike përmban të paktën:

- Automati kryesor me 4 faza 400V, me amperazh në varesi nga ngarkesa
- Automat me tre faza për çdo kat (sugjerojme që çdo kat të pajiset me linje tre fazore për një shpërndarje më të mirë të sigurisë të ngarkesës)
- Sinjale të fazave të treguara në kopertinën e saj
- Morseta e tokëzimit të lidhur me sistemin e tokëzimit

Montohet se bashku me komponentet, duhet të bëhet nga një specialist elektrik nën mbikëqyrjen e inxhinierit. Të gjitha lidhjet e percjellesave dhe kabllave brenda panelit do të bëhet me anë të kapikordave të vecanta për secilin tip seksioni dhe me nastro dhe ngjitese.

Paneli metalik duhet të jetë i lidhur me sistemin e tokëzimit.

Një shembull i panelit kryesor i tensionit të ulët është specifikuar si më poshtë:

- Montimi në sipërfaqe (të prodhuara flete metalike)
- Karkasa të prodhuara me fletë çeliku të pjekur në furrë
- Përmasat: sipas projektimit

Min. Temperaturave të instalimit -25°C Max.

Temperaturat instalimi 60°C IK Code 07 Test i ngrohjes teli 750°C

Kutitë e celesave të automateve

Kutitë e celesave të automateve janë panelet elektrike për zonën e veçantë, e njëjtë me panelet në kat, me një ndryshim se numri i paneleve është i reduktuar. Këto kuti do të përdoren në zona të ndryshme.

Montimi i kutive në suva do të bëhet me anë të vidave me mbajtëse, ndërsa këto nën suva do të jenë fikse me llaç dhe nuk duhet të jenë mbi nivelin e suvase.

Siguresat

Siguresat janë ndarëset e qarkut, të cilat operojnë në mënyrë automatike në rast të mbingarkesës dhe lidhjes së shkurter në qark të hapur. Për këtë përzgjedhja e Amperazhit të automateve është bërë duke marrë parasysh mbrojtjen e ngarkesës.

Automatet e përdorur në zona publike janë magneto-termik dhe me mbrojtje diferenciale. Automatet janë njësi mbrojtëse nga mbingarkesa. Ato vendosen në kutitë e automateve, në panelet e kateve dhe në panelin kryesor i tensionit të ulët.

Sipas numrit të fazës që mbrojnë ata janë një fazore dhe trefazor.

Sipas Amperazhit ato ndahen 6A: 10A; 20A, 25A, 32A, 40A, 50A, 63A, 100A

Sipas Amperit ata janë të ndarë 125A; 160A; 250A; 400A; 600A; 800A; 1250A; 1600A;

Sipas numrit të poleve automatet janë të ndarë: dy polare dhe katër polare.

2. Infrastruktura e instalimit elektrik

a) Tela dhe Kabllot:

Te gjithë telat dhe kabllot duhet të kenë certifikatën e miratimit nga autoritetet e miratimit dhe certifikatën e fabrikës. Do të realizohen me kablllo shumë polare FS17, FR-

OR 450/750 V, FG16-OR16 450/750 etj rezistent kundra djegies dhe emetimit te gazeve toksike.

Per qarqet e dritave te sigurise kabllot do te jene me izolim te dyfishte te tipit rezistent nga zjarri FG16-OR16.

Te gjitha kabllot do te verifikohen dhe llogariten sipas:

- Qellimit te perdorimit
- Verifikimit te renies se tensionit
- Verifikimit te nxehjes gjate lidhjeve te shkurtra

Telat duhet të jene përçues bakri të izoluar me PVC me bërthamë të vetme brenda përçuesit.

Telat e izoluar duhet të jetë me ngjyrë me të erret për të identifikuar fazën dhe neutrin. Të gjitha rastet kur kabllot PVC përfundojë në një bord të shpërndarjes se siguresave, pajisjet elektrike, etj duhet të lihen te lira nje sasi e caktuar prej tyre, per te nxjerre me vone ne rast se duhet pa shkaktuar tërheqjen e tyre.

Numri i kabllave i instaluar në tuba ose kanalina duhet të jenë të tilla që të mundësojnë etiketimte lehtë pa dëmtuar kabllot dhe kurrë nuk duhet të jetë më shumë se 40%.

Izolimi PVC i kabllave dhe telave të shumëfishtë ose me tel të vetëm duhet te jene te afte qe të rezistojnë deri 600/1000V.

Të gjitha kabllot e vënë brenda tubave duhet të izoloohen me përçueshmëri të lartë PVC.

Kabllot fleksibël të përbëhen nga tela me shumë shirita dhe në varësi të asaj që ne kemi:

- Kabëll me tre tela, 1 neutri, 1 toka (për sistemin mono faze)
- Kabëll me kater tela, 3 faze dhe 1 neutri(për sistemin e trefaze, pa toke)
- Kabëll me pese tela , 3 faza dhe 1 neutridhe 1 toka (për sistemin e trefaze, metoke)

Kanalinat dhe aksesoret

Instalimi elektrik mund të bëhet në dy mënyra :

- Nën suva e futur në tub fleksibël PVC
- Mbi suva në PVC dhe kanalina metalike

Pajisje e instalimit nën suva janë:

- tub fleksibël PVC me dimensione të ndryshme në varësi të dimensionit dhe numri i telave që do të vendosen në të.
- Kutitë e Shpërndarjes
- Kutitë për fiksimin e prizave ose celesave

Të gjithë ato duhet të vendosen para se suvatimi te jete bërë.

Instalimet elektrike nën suva duhet të bëhet sipas hapave në vijim:

- Hapja e kanaleve në mur me një dimension të tillë që tubi fleksibël të futet lirisht dhe një thellësi të tillë që mos te dali mbi nivelin përfundimtar te suvase.
- Fiskimi i kabllave fleksibël dhe tubave PVC përkohesisht me llac dhe me vone do te mbulohen me suva.
- Pas suvatimi është bërë, futja e telave apo kabllot me ane te sondes dhe do te futen lirisht dhe te kihet parasysh qe te lihen sasi te lira nga te dyja anet per nevoja te instalimit.

Kanalinat dhe tubat PVC fleksibel duhet të fiksohen në distancë prej 0.4 m pezull nga taveni dhe në menyre horizontale ose vertikale drejt prizave ose çelësve pa krijuar harqe ose kende.

Tuba, kutite

Brenda ndërtesës të gjithë kabllo do të jenë të vendosur në tuba sipas vizatimit të instalimeve tipike të një ndërtese. Kjo do të thotë se brenda dhe nën tavan instalimi do të jetë i tipit i mbyllur. Ndryshimi i llojit të instalimit duhet të bëhet me një kuti inkaso.

Kutite shpërndarjes, në varësi të sistemit që do të përdoret, janë nën suva dhe mbi të në mënyrë që menyra e fiksimit të tyre të jete me llac ose vidë.

Materialet dhe karakteristike të tyre teknike janë të njëjta si për tubat fleksibel.

Dimensionet e kutive të shpërndarjes ndryshojnë sipas rrethanave dhe nevojave. Ata janë në formë rrethore, katrore, drejtkëndësh dhe kapaket e tyre mbulues janë me ngjyra të ndryshme.

Është e rëndësishme që lidhja e kabllave ose telave brenda kutive të realizohet me xhunto.

b) Etiketimi

Të gjitha kabllo do të etiketohen sipas skemës së paneleve të shpërndarjes me numrin e tyre të qarkut.

c) Sistemi i kanalave

Nëse kabllo ose përçuesit janë instaluar për përdorim të mëvonshëm apo hapësirë të lirë kjo do të shënohet edhe në etiketë.

I njëjti informacion duhet të sigurohet në të dy skajet e kabllave dhe përçueseve

Sistemet e kanalave të sistemit nën suva me tuba fleksibel duhet të përfundojnë në përputhje me të gjitha kushtet teknike të instalimit elektrik

Sistemi i kanalave duhet të jetë sipas standardeve të duhura.

- Sistemi i kanalave të përbëhet nga pajisje të tilla si:
- Kanalina me dimensione të ndryshme, në varësi të numrit të telave / kabllave, prizave, çelësve etj, të jetë e instaluar në të me gjatësi 2 m
- Këndet (shërbejnë për të formuar një kënd në instalimin) që varen nga kanalet që janë përdorur
- Devijimi në formë T
- Kanalina me dy divizione të veçanta.

Montimi i kanalave të bëhet me vida, dhe të vihet 0.4m nën nivelin e tavanit.

d) Ndrivesat e brendshëm dhe llambat

Të gjithë ndriçuesit duhet të jenë të pajisur me drosela elektronike me përjashtim kur janë të prodhuar ndryshe, me terminale (seksioni min. 1,5 mm²) dhe terminaleve të dyta për të lidhur një ndriçues në vijim. Në rastin e lidhjeve të dy kabllave në një instalim duhet të ketë edhe dy kablllo me mbrojtje në bazë të shkallës mbrojtjes.

Të gjithë ndriçuesit e brendshëm janë të pajisura me llambat fluoreshente tub, dhe spotet me llambat fluoreshente kompakte, LED Light etj sipas zgjidhjes së dhënë në projekt dhe përshkrimin e tyre në vizatime dhe në specifikime teknike. Për zyrë dhe ambiente të tjera të ngjashme rekomandohet përdorimi i ndriçimit direkt ose indirekt. Për tualete dhe të

ngjashme do të përdoren spote. Për të gjitha dhomat e pajisjeve dhe dhoma me lagështi do të përdoret ndriçim me rezistence të lartë. Kabllot do të përdoren sipas specifikave të fabrikës.

Gjatë gjithë zonës së tavanit të varur ku ndriçuesi fluoreshent do të instalohet, lidhjet e fundit të çdo ndriçuesi do të bëhen me anë të një kabllimi me tre tela rezistent ndaj nxehtesise dhe me cilësi të përshtatshme nëpërmjet një prizë në tavan e lidhur me kutinë e kanalave. Pamja dhe karakteristikat e shpërndarjes së ndriçuesve duhet të përputhen me informacionin e detajuar e dhënë në këtë specifikim.

6.1 Linjat e shpërndarjes të rrjeteve sekondare

Implantet e rrjeteve të shpërndarjeve dytesore, nisen nga kuadrot e zonave apo të kateve dhe parashikojnë:

Rrjetin N: Impianti i ndricimit

Rrjetin F: Impiantin e fuqise

Rrjetin KI: Impiantin e “përdoruesve informatike”

Rrjetin KP: Impiantin e “përdoruesve profesionale”

Rrjetin KE: Impiantin e “ndricimit të sigurisë” 230/400 VAC (shërbimet e sigurisë klasi 0.5)

Ne drejtim të kuadrove të katit/zonës shpërndarja sekondare e rrjetit elektrik do të realizohet me kanaline metalike të zinkuar të birezuar, të montuar brenda tavaneve të varur në korridore duke parashikuar duke pasur parasysh që këto rrugekallime të kanalave lejojnë lehtësisht inspektimin e tyre si dhe janë të koordinuara me implantet e tjera mekanike.

Natyrisht kanalimet metalike do të jenë të dimensionuara në mënyrë të tillë që të lejojnë një rezervë (deri 20%):

Kabllot do të jenë të tipit rezistent ndaj djegies dhe me emision të ulët të tymit dhe gazeve toksike e korrozive të tipit FGTOM1 0.6/1 kv (sipas CEI 20-22, 20-37, dhe 20-38).

Linjat kryesore do të jenë në përgjithësi të instaluar tek kuadrot e zonave, nëse ka ose në kutitë e derivacionit për ushqimin direkt të konsumatorëve në këtë zonë. Kutitë e derivacionit të instaluar përgjatë linjës kryesore do të jenë të tipit PVC në dimensionet e përshtatshme sipas numrit dhe dimensionit të kabllit, të kompletuar me morseteri të derivacionit fikse të tipit modular të fiksuar në mure ose në kanaline metalike.

7. KUADROT ELEKTRIKE

Kuadrot elektrike do të jenë të ndara sipas rendesise, shërbimeve që ato mbulojnë dhe zonave në të cilat operojnë. Kështu do të kemi:

7.1 Kuadrot elektrike të zonave / kateve.

Do të kenë një strukturë modulare, metalike me porte mbrojtëse transparente. Në brendësi të tyre do të ketë kompartimente të vecanta për pajisjet e seksioneve të ndryshme, zbarat e shpërndarjes si dhe morseteri të etiketuara sipas linjave. Do të jenë në përgjithësi të përbërë nga tre seksione të vecanta që lidhen me qarqet e ndricimit, prizave, pajisjeve informatike apo teknike.

Në çdo rast komutatorët do të jenë të bllokuar me çelës dhe nderhyrja tek ato do të bëhet vetëm nga persona të autorizuar. Qarqet e tjera të rrjetit janë ushqyer nëpërmjet automateve mbrojtës të tipit modular apo skatolare, magnetotemik dhe/ose

magnetotermik diferencial, me mundesine per te nderhyre sipas skemave unifilare te paraqitura ne vizatime.

Ne vecanti qarqet qe furnizojne nenkuadrot elektrike te ambjenteve do te jene te mbrojtur nga Automate me karakteristika te tilla qe lejojne selektivitet krahasuar me automatet mbrojtës te vete nenkuadrit. Automatet kryesore do te jete te pajisur me nje buton emergjence qe lejon shkeputjen e energjise elektrike ne raste te vecanta nga vete kuadri ose nga kuadri kryesor qe i furnizon keto nenkuadro.

7.2 Automatat

7.2.1 Panelet kryesore te shperndarjes te rrjetit dhe gjeneratorit

7.2.1.1 Standartet

IEC 60439 : Panelet e tensionit të ulët dhe assemblimi i kuadrove - Pjesa 1 Lloji testuar dhe pjesërisht lloji i testuar i assemblimit.

IEC 60947 : Panelet e tensionit të ulët dhe kontrolli i tyre

7.2.1.2 Karakteristikat teknike

- Forma dhe sistemi i tokëzimi : siç është përmendur në diagramin me një linjë
- Me pajisjet e vizatuara siç tregohet në diagramet një linjë
- Në përputhje me rregulloret lokale të kompanisë elektrike
- Shkalla Mbrojtja IEC 529: IP 31 / IP 20 me dyer të hapura
- Tensioni i vlerësuar: 690 V
- Tensionit operativ: shih diagramin një linjë
- Nuk ka përdorim të lëngjeve
- Pa siguresa, të gjitha mbrojtjet me anë të automateve me njësi elektronike të ndaljes
- Pajisje matëse dixhitale në TRMS(vlerat e vërteta) për çdo furnizim të përgjithshme për:
 - 3A, 3V, kW, KVAR, kVA, Hz, cos.phi
 - Pmax. dhe I1, I2, I3 max. në 8, 10, 15, 20 ose 30 min.
 - Regjistrimi i vlerave max.
 - Transmisione alarmi për perseritje (kontakte të thatë)
 - Pajisje mrojtëse për mbtension në cdo fazë.
 - Korrigjim automatik për faktorin e fuqisë :
 - filtra harmonike
 - Ndryshim automatik të baterive të kondensatorit për të garantuar të njëjtat ore pune për të gjithë kondensatorët.
 - Tipi i thatë
 - IEC 60.831-1 / 2
 - Llogaritjet e perzgjedhjes të dorëzohen (diskriminim)
 - Të gjitha cilësimet janë testuar dhe vëlosur
 - Raport testimi për t'u dorëzuar

7.2.1.3 Permasat / Pësia

Nuk ka specifikime të veçanta. Akses në kabinet dhe kabllot të hyrjes në përputhje me kushtet e hapësirës lokale.

Montimi në dhomën teknike dhe kontrolli i tij

7.2.1.4 Niveli i zhurmes

Nuk ka kërkesa të veçanta.

7.2.1.5 Kodi mates

Te gjithë kabinetet duke përfshirë dhe buzarrat dhe kabllimet e brendshme të përfshira në cmim.

8. SHPERNDARJA FUNDOR E RRJETIT TE FUQISE DHE NDRICIMIT.

Rrjeti i shpërndarjes së fuqisë, prizave do të furnizohet nga kuadrot sekondar ose nga kutitë e shpërndarjes me të afërta. Në përgjithësi ky rrjet do të shpërndahet nëpërmjet tavaneve të varur apo nënsuva duke përdorur tuba plastik rigid apo fleksibel. Numri i daljeve për çdo ambient do të përcaktohet në funksion të kërkesave teknologjike dhe shërbimeve të tjera që ka ai ambient. I gjithë rrjeti do të përbehet nga qarqe të ndryshme në funksion të burimit të energjisë që kërkon, kështu brenda një ambjenti do të kemi maksimumi 3 qarqe elektrik të pavarur nga njëri-tjetri të cilët do të përfundojnë në prizen perkatese e cila do të identifikojë nëpërmjet ngjyres cilit qark i perket. Kështu do të përdoren fruta me ngjyre të bardhe për rrjetin normal, jeshile për rrjetin e gjeneratorit dhe të kuqe për UPS. Dimensionimi i kabllave do të bëhet sipas llogaritjeve për ngarkesën perkatese të konsumatoreve, distancën nga burimi i energjisë dhe normave të lejuar të rënies së tensionit në linjë të cilat nuk duhet t'i kalojë 4%.

8.1 Rrjeti i fuqisë

Karakteristikat kryesore të impiantit të fuqisë, brenda ambjenteve të ndryshme mund të përshkruhen si më poshtë:

Seti i instalimeve të posteve të punës në këto pajisje do të ketë të pakten:

- Nr 2 prizë universale 2x16A+T të furnizuara nga rrjeti fuqisë normale, F dhe Nr.2 prizë universale 2x16A+T të furnizuara nga rrjeti i privilegjuar.
- Nr. 2 prize rrjeti Rj-45 për rrjetin data dhe 1 prize për telefoninë.

8.2 Shpërndarja e brendshme dhe instalimi i fuqisë

8.2.3 Standartet

Ligjet dhe normat Shqiptare në fuqi

- Normat dhe standartet evropiane:
- IEC 60.364 Ngritja e instalimit në tension të ulët
- EN 50.085 Sistemet e kanaleve të kabllave sistemet e kanalëve të kabllave për instalimet elektrike
- EN 50.086 Sistemet e përcjellesave për menaxhimin e kabllave
- EN 50.102 Shkallët e mbrojtjes të ofruara nga mbyllja për pajisjet elektrike ndaj ndikimit të jashtëm mekanik
- EN 50.298 Rrethimi bosh për automatet e tensionit të ulët dhe të kontrollit të veshjes
- EN 50310 Aplikimi i lidhjes ekuipotenciale dhe tokëzimi në ndërtesa me pajisjeve të teknologjisë së informacionit
- EN 50.334 Shënimi nga mbishkrimi për identifikimin e berthames së kabllave elektrike

- EN 60.309 Priza, kutite e prizave dhe bokset për qëllime industriale
- EN 60.423 Percjellesit për qëllime elektrike
- EN 60529 Shkallët e mbrojtjes (kodi IP)
- EN 60.669 Celesat për shtepite dhe instalime të ngjashme elektrike fikse
- EN 60.865 Llogaritja e efekteve për rrymat në qark të shkurter
- EN 60.947 Automatet e tensionit të ulët dhe kontrolli i tyre
- EN 61.537 Sistemet kanalinave të kabllave dhe sistemet për menaxhimin e kabllave
- EN 61.543 Pajisjet mbrojtëse (RCD)

8.2.4 Karakteristikat teknike

Telat dhe kabllot duhet të plotësojnë kërkesat e aplikueshme për llojin e izolimit, veshjes, dhe specifikat e përçuesve ose të shënuara. Telat dhe kabllot prodhuar më shumë se 12 muaj para datës të dorëzimit në vend nuk duhet të përdoren.

Përçuesit: Përçuesit duhet të jenë solid ose komponimi sipas seksionit kryq. Të gjithë përçuesit do të jenë prej bakri. Nëse nuk tregohet në mënyrë specifike ose të jete kërkuar nga prodhuesit e pajisjeve.

